



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

RELACION TEKNIK

‘RIKONSTRUKSIONI I SEGMENTEVE RRUGORE RURALE, BORSH - KUÇ’

VENDODHJA: BASHKIA HIMARE

TETOR 2018

Segmenti rrugor *Borsh-Fterre-Kuc* zhvillohet ne terren teresisht malor me bazament te qendrueshem shkembor. Gjeresia e ndryshueshme e rruges (ne disa raste 3-4m), si dhe rrezet shum te vogla veshtiresojne kalimin e automjeteve.

Pjerresit gjatesore jane te medha, vlerat e te cilave levizin nga 4%-17%.

Rruga eshte tej mase e amortizuar per shkak te mos disiplinimit te ujrave. Kanalet e dheut jane kryesisht te bllokuara dhe jasht pune.

Kemi nje numer te konsideruar te tombinove ekzistuese pjesa me e madhe e te cilave jane jasht pune per shkak te bllokimit te tyre.

Rruga pershkon disa zona te banuara, dhe eshte plotesisht e pa trajtuar me infrastrukturat e nevojshme urbane.

Aksi rrugor zhvillohet ne gjurme ekzistuese dhe ka keto karakteristika :

- Gjatesia prej rreth 23.8km.
- Gjeresia variabel te trupit te rruges qe rezulton nga 3-5 m
- Bankina ekzistuese me gjeresi mesatare 0,5 m
- Pjerresite gjatesore qe rezultojne deri 17%

Ky segment fillon ne kryqezimin me rrugen nacionale Vlore-Sarande ne dalje te Borshit. Hyrja per ne kete segment eshte mjaft e rrezikshme dhe perben nje burim aksidenti per mjetet. Kjo pershkak te mos fushpamjes si dhe te rrezeve te vogla ne dalje.



Kryqezimi me rrugen nacionale Vlore-Sarande

Ne pjesen e para ne fshatin Borsh deri ne Km0+600 rruga zhvillohet ne nje qender te banuar jo e trajtuar plotesisht me te gjitha elementet urbane. Rrezet jane mjaft te vogla gje qe veshtiresojne shume shkembimin e automjeteve. Gjithashtu dhe pjerresit gjatesore ne kete zone arrijn vlera te medha deri ne 15%.

Me tej rruga vazhdon ne drejtim te fshatit Fterre, dhe pershkon ate pas rreth 11 km. Edhe ne kete pjese eshte per tu permendur mugesat e infrastrukture si dhe problemet inxhinierike dhe gjeometrike te rruges sic jane:

- Rruga eshte tejmas e ngushte me nje gjeresi variabel 2.5-5m
- Rrezet jane te vogla dhe jasht cdo standarti
- Pjerresit gjatesore arrijn vlera te medha deri ne 17%
- Mungesa e dukshme e kanalizimeve dhe e kullimit te ujrave te shiut
- Veshtirsia e shkembimit te automjeteve

- Mungese e sinjalistikës si dhe e barrierave mbrojtëse



Hyrje dhe Dalje fshati Fterre

Ne Km 10+100 rruga kalon neper nje qender te banuar (fshati Fterre). Kemi mungese te dukshme te elementeve urbane sidhe probleme inxhinierike dhe gjeometrike gjithashtu. Ne kete zone rruga eshte tejmas e ngushte si dhe rrezet jane teper te vogla. Kanalet e dheut jane pothuajse jasht funksioni te cilet nuk arrijn dot te bejn nje disiplinim te ujrave. Rruga eshte totalisht e amortizuar dhe jasht funksioni. Rrezet jane shum te vogla dhe te veshtira per tu shkember dy automjete.



Foto nga fshati Fterre

Me pas gjurma e rruges vazhdon ne drejtim te fshatit Kuc duke pershkuar nje segment rrugor me gjatesi rreth 11.3 km.

Edhe ketu kemi te bejm me te njejtat probleme te rruges

Fshati Kuc

Ne zona te vecanta, sidomos ne Qafe Derrase, rezultojne pjerresi mjaft te medha gjatesore (rreth 17 %), qe veshtiresojne ne menyre ekstreme kalimin e mjeteve.

Qafe Derrase

Shtresat rrugore jane prej materiali te thyer natyral, ne te shumten e rasteve te pangjeshur. Ashpersia e madhe e siperfaqes rrugore si pasoje e me siper krijon efektin guzhinete ndermjet gomave te mjeteve dhe siperfaqes rrugore duke rrezikuar seriozisht daljen jashte karrexhates te mjeteve perdorues.

Ne Km 22+200 kemi fshatin Kuc te cilin rruga e pershkon ne nje gjatesi rreth 1Km. Muret e larta ekzistuese jane ne gjendje te mire pune. Rruga eshte mjaft e ngushte edhe ne kete segment dhe e vestire per shkembimin e automjeteve.



Sheshi eshte i shtruar me asfalt por gjendja e te cilit eshte e amortizuar. Pjerrisit dhe disiplinimi i ujrave eshte mjaft i crregullt. Edhe ketu mungojne elementet urabe si dhe sinjalistike .

Ne dalje te sheshit eshte nje rrap shumvjecar i cili nga ana e konsulentit eshte konceptuar te ruhet. Ne kete nyje rrezt jane shume te vogla dhe pothuajse e pamundur per shkembim automjetesh.

Segmenti rrugor pershkon nje zone te pasur me burime ujore si dhe perrenj malore. Per kete shkak ne kete segment jane ndertuar nje numer i konsiderueshem vepra arti qe kane disiplinuar rrjedhjet perkatese (tombino rrethore e katrore me dimensione te ndryshme 300mm-1500mm dhe ura te vogla deri 6m).



Nderhyrjet konsistojne kryesisht ne skarifikim bari, germim dheu, germim kanalesh, rrafshim skarpate, mur guri mbajtes, shtrese cakelli.

Keto nderhyrje konsistojne ne llojet e nderhyrjeve emergjente deri ne pritje ten je projekti te plote rehabilitues te te gjithë rrugeve te mesiperme.

Pergatiti : ing.BEXHET ÇOBANI

Top.JORGAQ GJATI

Tetor 2018